

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.109/2017, “PËR BUXHETIN E VITIT 2018”, TË NDRYSHUAR”

MËNYRA E NDËRHYRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101, të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24, datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014, etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë¹:

1. *Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;*
2. *Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;*
3. *Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;*
4. *Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.*

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;

Neni 101 ka parashikuar “nevojën” dhe “urgjencën” si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2018. Ky rishikim propozohet t’i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekti i nevojës dhe emergjencës së të cilit lidhet me këto arsye kryesore:

- ✓ *Ruajtja e nivelit të planifikuar të parametrave kryesorë makroekonomikë 2018, të tillë si: niveli i deficitit buxhetor, si edhe niveli i suficitit primar në terma pozitivë, si nominalë ashtu edhe kundrejt PBB-së.*
- ✓ *Sigurimi i hapësirës financiare shtesë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmes rritjes së tavanit të shpenzimeve të tyre me 3.4 miliardë lekë, në përputhje me ecurinë pozitive të mbledhjes së të ardhurave vendore.*
- ✓ *“Pastrimi” i detyrimeve të prapambetura në sektorin e infrastrukturës, në masën 2.2 miliardë lekë, në përputhje me angazhimin e marrë edhe kundrejt FMN-së.*
- ✓ *Rritja e efikasitetit të përdorimit të burimeve publike për rialokime drejt projekteve të investimeve me progres të mirë deri tani;*
- ✓ *Rritja e sigurisë në realizimin e treguesve të buxhetit të shtetit, në tërësi;*

¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 10.11.2006

Njëkohësisht, **nevoja dhe urgjenca** konsiston edhe në faktin se:

- a) *Bëhet e mundur shlyerja në kohë e detyrimeve financiare kontraktuale të institucioneve buxhetore, nëpërmjet rialokimeve buxhetore me efekt neutral. Kështu reduktohet mundësia e mbartjes së detyrimeve të prapambetura për vitin e ri buxhetor 2019.*
- b) *Rritet performanca e shpenzimeve kapitale, përmes rialokimit të fondeve mes projekteve të investimeve publike (me financim të brendshëm dhe të huaj), duke synuar “zhvendosjen” e burimeve nga projektet me ecuri të ngadaltë dhe/apo jashtë skedulit të parashikuar, drejt atyre me performancë më të lartë disbursimi dhe punë të kryer.*
- c) *Garantohet mbulimi me fonde buxhetore për disa çështje sensitive, përkatësisht:*
- *Financimi i konvikteve të studentëve në Bashkinë Tiranë, në masën 300 milionë lekë (MAS);*
 - *Financimi i investimit për Kampusin Universitar Durrës, në masën 150 milionë lekë (MAS);*
 - *Financimi i projektit të rikonstruksionit të Teatrit të Operas dhe Baletit në masën 210 milionë lekë (Ministria e Kulturës);*
 - *Akomodimi i financimit të nevojshëm shtesë për Spitalin e Traumës në masën 470 milionë lekë dhe për projektin e Bankës Botërore “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë” në masën 500 milionë lekë;*
 - *Shlyerja e detyrimeve të prapambetura të disa institucioneve buxhetore, për vendime gjyqësore, gjithsej në masën 433 milionë lekë;*
 - *Shlyerja e faturave të vitit 2018 kundrejt kompanisë Microsoft, në masën 650 milionë lekë (AKSHI);*
 - *Rritja e mbështetjes buxhetore me burime të huaja për energjinë në masën 1.2 miliard lekë, përmes alokimit të këtij fondi në programin “Mbështetje për energjinë”.*
- ç) *Rritet me 2.1 miliardë lekë plani i të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore, meqënëse aktualisht:*
- ✓ *Të ardhurat tatimore në total si 11-mujor janë tejkaluar me 400 milionë lekë.*
 - ✓ *Të ardhurat nga zëri “Taksa lokale” janë realizuar rreth 13.9 miliardë lekë, me një tejkalim të planit vjetor në masën 35% ose rreth 3.6 miliardë lekë më shumë se plani vjetor. Mbështetur në realizimin e 11-mujorit dhe rivlerësimit të potencialit të të ardhurave nga ky zë i taksave vendore propozojmë që plani i të ardhurave për vitin 2018 për taksat lokale të rritet me 4.5 miliardë lekë.*
 - ✓ *Për periudhën janar-nëntor 2018 të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël janë tejkaluar, si rrjedhojë propozojmë që plani i vitit 2018 të shtohet me 100 milionë lekë.*
 - ✓ *Nga taksat e pasurisë janë mbledhur 4.8 miliardë lekë, përkundrejt planit prej 8.1 miliardë. Nga një rivlerësim nga bashkitë pritet që për vitin 2018 nga kjo taksë të mbledhen rreth 5.3 miliardë lekë. Në këto kushte, propozohet ulja e të ardhurave nga taksat e pasurisë me rreth 2.8 miliardë lekë, vlerë kjo e cila do të shtohet pranë zërit të planit të taksave lokale.*
 - ✓ *Gjatë vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë shlyer detyrime të prapambetura për një shumë rreth 2.1 miliardë lekë. Disa nga njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë zbatuar projekte me financim të huaj, ku plani i tyre nuk ka qenë i parashikuar në buxhetin fillestar të vitit 2018. Po ashtu,*

njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë trashëguar fonde nga vitet e mëparshme duke krijuar nga viti në vit një stok që ka rritur presionin për të kryer shpenzime. Në këto kushte, është i domosdoshëm edhe krijimi i hapësirës fiskale në rreth 1.3 miliardë lekë për mbulimin me plan buxhetor të shpenzimeve me financim të huaj për pushtetin vendor.

- d) *Korrektohet niveli i të ardhurave të përgjithshme buxhetore, për të reflektuar reduktimin e të ardhurave tatimore&doganore me 2.13 miliardë lekë, si pasojë e efekteve negative të kursit të këmbimit, që ndikuan ecurinë e mbledhjes së tyre gjatë vitit 2018.*
- e) *Një argument tjetër për ndryshimet e bëra është edhe nevoja që Këshilli i Ministrave, si ushtruesi më i madh i së drejtës së iniciativës ligjvënëse, dhe vetë Kuvendi të veprojnë pa cenuar ekonominë ligjvënëse, që nënkupton se, me rastin e ekzistencës së nevojës dhe urgjencës për disa ndryshime në ligjin e buxhetit, mund të adresohen njëkohësisht edhe ndryshime të tjera jodomosdoshmërisht urgjente. Një gjë e tillë është logjike e kursimit legjislativ, duke mos angazhuar Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin në procese legjislative të herëpashershme dhe të së njëjtës natyrë.*

Gjithashtu, është me rëndësi të ritheksohet që ndryshimet e propozuara nuk prekin treguesit kryesorë makroekonomikë dhe fiskalë, duke ruajtur deficitin në nivele të pandryshueshme e duke forcuar më tej objektivin e qeverisë për qëndrueshmëri fiskale.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45 (dyzet e pesë) ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky akt do të dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ AKTI NORMATIV

Bazuar në performancën makro - fiskale e buxhetore të 11-mujorit 2018, akti normativ që ju propozojmë do t'i japë zgjidhje disa problematikave të hasuara gjatë implementimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, duke rritur efikasitetin në përdorimin e fondeve publike, duke bërë të mundur arritjen e tre objektivave të rëndësishëm si:

- i. *Ruajtjen të pandryshuar të nivelit të planifikuar të parametrave kryesorë makroekonomikë;*
- ii. *Garantimin e financimit të nevojave të pushtetit vendor;*
- iii. *“Pastrimin” e detyrimeve të prapambetura.*

KËSHILLI I MINISTRAVE